



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	183/23
Nr. i fq. / Br. sh	-3-
Data / Datum	27.07.2023
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 7 KORRIK 2023**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 15:15.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nuri Halili, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Adnan Lahu, Agim Bregaj, Bujar Pllana, Edona Gashi, Gentiana Rama, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Mek Selaci, Shkelzen Xhaferi dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 25 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Pas shqyrtimit të rendit të ditës , kuvendit pas votimit me 24 vota “për” aprovoj këtë:**

**R E N D I T E**

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit 81/23 i datës 30.03.2023 për bartjen e të hyrave vetanake paraprake nga viti 2022 në vitin 2023.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti** sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit 81/23 i datës 30.03.2023 për bartjen e të hyrave vetanake paraprake nga viti 2022 në vitin 2023, duke shtuar se ndryshimi i këtij vendim duhet bëhet pas aprovimit ligji në nivel qendrorë për bartjen e të hyrave vetanake, por që e

rëndësishme është se struktura e shpenzimeve do të ruhet ku ndër të tjera janë me sa vijon: Mallrat dhe Shërbimet janë: 163,595.75 €, Shpenzimet komunale, 6,090.20 €, Subvencionet dhe Transferet 146,055.43 €, Shpenzime kapitale 832,269.05 €, ndërsa **totali i të hyrave të bartura është 1,148,010.43 €**. Kjo do të thotë se struktura e shpenzimeve është ruajtur, ndërsa ndryshimet brenda për brenda kategorisë mund të bëhen, sipas të kërkesave të drejtorëve të drejtorive, e që në këtë drejtim me këto të hyra të bartura do të mbulohen shumë obligime kontraktuale që dalin nga kontrata e lidhura më herët.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-tha se si grup kuvendar i LVV-së do ta mbështesin bartjen e të hyrave vetanake nga vitet paraprake, por në këtë kontekst parashtroj një rekomandim i cili ka qenë publik për qeverinë komunale, që në kuadër të këtyre të hyrave të ndihmohen familjet e prekura nga vërshimet e fundit që kanë ndodhur në Komunën e Vushtrrisë, me theks të posaçëm ato që kanë pësuar dëme në ekonomit bujqësore dhe pronat shtëpiake. Në fund deklaroi se me zemërgjerësi dhe konstruktivitet do ta përkrahin këtë vendim të sotshëm, por kërkoj transparencë dhe do të kërkohej llogaridhënie për të gjitha ato mjetet që do të ndahen në kompensimin e dëmeve që janë shkaktuar nga vërshimet.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 24 vota “për” 1 votë “abstenim” dhe duke i’ bashkangjitur këtij propozim-vendimi, rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake për vitin 2022 në vitin 2023 në kategoritë si në vijim:

Mallrat dhe Shërbimet.....	163,595.75 €
Shpenzimet komunale.....	6,090.20 €
Subvencionet dhe Transferet .....	146,055.43 €
Shpenzime kapitale .....	832,269.05 €
<b>Totali.....</b>	<b>1,148,010.43 €</b>

2. Në kategorinë **Mallrat dhe shërbimet, bartja bëhet si në vijim:**

Zyra e kryetarit (16024), shuma prej.....	30,592.70 €
Planifikimi urban dhe inspeksioni (66425), shuma prej.....	20,000.00 €
Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), shuma prej.....	65,982.52 €
Arsimi parshkollor (92670), shuma prej.....	29,420.75 €
Arsimi i mesëm i lartë (94890), shuma prej.....	17,599.78 €

3. Në kategorinë **ekonomike shpenzimet komunale bartja e mjeteve finciare bëhet si në vijim:**

**3.1. Infrastruktura publike (18184), shuma prej.....6,090.20 €**

**4. Në kategorinë ekonomike Subvencionet dhe Transferet bartja e mjeteve finciare bëhet si në vijim:**

Zyra e kryetarit (16024), shuma prej.....146,005.43 €  
Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), shuma prej.....50.00 €

**5. Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale bartja e mjeteve finciare bëhet si në vijim:**  
**6. Infrastruktura publike (18184), në projektet:**

Ndrtimi i vigave mbi Lumin Silnica, Tërstena dhe Stanoc kodi(51827)shuma prej 40,000.00 €  
Ndertimi i rruges Vesekoc-Baçkë (me zhavorr) kodi (i ri), shuma prej 20,000.00 €  
Ndertimi i rr. me kubeza betoni fsh Reznik (lagja Halili) (i ri), shuma prej 14,000.00 €  
Ndërtimi i rrugës me kubëza betoni rr. "Hazir Gjaka" kodi (53297),shuma 4,887.50 €  
Ndërtimi i urës mbi lumin "Podranqa" Vushtrri (i ri), shuma 50,000.00€  
Ndërtimi i rrugës me kubëza betoni rr. "Miftar Hasani" kodi (53298),shuma 750.00 €  
Ndërtimi i rr. me kubëza bnetoni rr. "Albania" Sfaraqak (i ri), shuma 9,000.00 €

**7. Bujqësia (47024), në projektet:**

Rregullimi dhe pastrimi i lumit Llap- Silnica kodi (52290), shuma prej 305,368.00 €  
Projektet në bashkëfinancim me donatorë kodi (49561) ), shuma prej 264,975.40 €

**8. Sherbimet kulturore (85024), në projektin:**

Renovimi i palestrës "Jeton Terstena" (eletrika-trafo) – Vushtrri(i ri), Shuma 60,000.00€

**9. Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), në projektet:**

Rregullimi i oborrit të QKMF-së Vushtrri(52749),shuma 20,654.15€  
Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF (52190), shuma 38,934.00 €  
Blerja e gjeneratorit për QPS Vushtrri (53629),shuma 3,700.00€

**10. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.**

**11. Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimi të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**Mbledhja përfundoi në ora: 15:22.**

**Bastri Duraku**

  
Procesmbajtës

**Melihate Basholli-Latifi**

  
  
Kryesuese e Kuvendit